



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Objekti: Shërbime Organizimi të Eventeve Sportive (CPV – 92622000-7)

Tabela e Përmbajtjes

Terma Reference për Organizim Event Sportiv të organizuara nga "Ekipet Sportive në Shkollë"
" Procedure Prokurimi për Organizimin e Ceremonisë "Hapja e Projektit Ekipet Sportive në Shkollë"
Viti III "

<i>Ref: Shërbime Rekreative Kulturore dhe Sportive</i>	
1. Rreth KOKSH	2
2. Rreth shërbimit të kërkuar	2
3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi	4
4. Metodologjia dhe plani i punës	3
5. Kualifikimet e nevojshme	3
6. Procesi i aplikimit	4
7. Dorëzimi i ofertave	5
8. Afati i Aplikimit	6
9. Procesi i Vlersimit	6
10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak	6



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

2. Objekti i shërbimit të kërkuar: Sherbime organizimi të ngjarjeve sportive dhe kulturore.

Për të përmbushur misionin e organizatës dhe për të shpërndarë frymën Olimpike më tej, KOKSH planifikon të organizojë evente sportive, ndeshjet në bashki, ndeshjet në nivel qarku, dhe ndeshjet finale të përmbylljes së kampionatit sipas kalendarit të ndeshjeve dhe sipas nevojave për çdo event që do të organizohet.

Nëpërmjet kësaj thirrje të hapur, KOKSH fton individët/ekipet/kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre sipas specifikimeve të mëposhtme.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.

Nr.	Emërtimi	Specifikim Teknik	Njësia	Sasia	Cmim/Njësi	Vlera/Lek	Burimi i Financimit	Kohezgjatja
1	Procedure Prokurimi per Organizimin e Ceremonise “Hapja e Projektit Ekipet Sportive ne Shkolla Viti III”	Kerkojme 2 subjekte ku secili prej tyre te mbuloje sherbimet si me poshte: 1.Realizim eventesh te ngjarjeve sportive i cili ofron sherbimet dhe materialet si: -Projektor, Led Wall - Transport materiale+pastrime -Dj, Foni - Flamuj te ndryshem - Ndricim - Koriondole - Adezive 2.-Catering per 600 persona	Numer sherbimesh	Sherbime	1.000.000 leke	1.000.000 leke	Qeveria Shqiptare financim projekti “Ekipet Sportive ne Shkolla”.	1 dite (11 Tetor 2024) Organizimet e eventeve sipas kalendarit te miratuar nga Ekipet Sportive

4. Metodologjia dhe plani i punës

Në kuadër të procedurës së prokurimit për organizimin e ceremonisë së hapjes së projektit “Ekipet Sportive në Shkolla – Viti III”, do të angazhohet individi, ekipi apo kompania që do të paraqesë ofertën më të përshtatshme dhe konkurruese, si në aspektin financiar, ashtu edhe në atë teknik dhe logjistik.

Procesi i punës përfshin:

- **Vlerësimin e ofertave** të paraqitura në bazë të kriterëve të përzgjedhjes të përcaktuara në dokumentacionin e prokurimit.
- **Përzgjedhjen e ofruesit** që paraqet kapacitetet më të mira për të realizuar ceremoninë sipas standardeve të kërkuara.
- **Hartimin dhe zbatimin e një plani të detajuar të punës**, që përfshin:

-Koordinimin me institucionet përkatëse dhe palët e interesuara.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

-Organizimin logjistik të hapësirës ku do të zhvillohet ceremonia (skena, ndriçimi, zëri, ambienti, etj.).

-Menaxhimin e aspekteve ceremoniale, përfshirë protokollin, listën e të ftuarve, axhendën dhe aktivitetet shoqëruese.

-Sigurimin e materialeve promocionale, dekorit dhe çdo elementi tjetër të nevojshëm për realizimin dinjitoz të ngjarjes.

Qëllimi është realizimi i një ceremonie dinamike, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me objektivat e projektit, duke promovuar vlerat e sportit dhe pjesëmarrjen e nxënësve në aktivitetet fizike në shkolla.

5. Kualifikimet e nevojshme

Për të qenë të pranueshëm në këtë procedurë prokurimi, individët, ekipet apo kompanitë pjesëmarrëse duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- **Eksperiencë profesionale:** Të kenë minimumi 2 vite përvojë në organizimin e eventeve, në veçanti të ngjarjeve me karakter kulturor, sportiv dhe institucional.
- **Eksperienca të mëparshme të ngjashme:** Të kenë realizuar me sukses të paktën evente të përmasave të ngjashme, të dokumentuara përmes kontratave, referencave apo materialeve të tjera mbështetëse.
- **Kapacitete teknike dhe logjistike:** Të disponojnë infrastrukturën dhe burimet e nevojshme për realizimin e ceremonisë, përfshirë pajisjet teknike (zë, ndriçim), logjistikën e ambientit, ekipin organizativ dhe çdo komponent tjetër të domosdoshëm.
- **Aftësi organizative dhe menaxheriale:** Të jenë në gjendje të hartojnë dhe zbatojnë një plan të qartë pune dhe të bashkëpunojnë ngushtë me institucionet publike dhe partnerët e projektit.
- **Përputhshmëri me kërkesat ligjore:** Të jenë të regjistruar si subjekt ligjor aktiv dhe të mos kenë pengesa ligjore për pjesëmarrje në procedura prokurimi.

6. Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Oferta Financiare per event.
- NIPT-in e biznesit
- Adresen e sakte.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

7. Dorëzimi i ofertave

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

Tirana Olympic Park

Rr. "Liman Kaba"

Tiranë, Shqipëri

P.O. Box 63

Email: secretary.general@nocalbania.org.al

8. Afati i Aplikimit

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 07.10.2025 jo më vonë se ora 16:00.
- Ofertat duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe.

9. Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet sipas sistemit të pikezimit si më poshtë vijon:

Përshkrimi	Pesha në vlerësim %
Eksperiencat e punës/CV e firmës/individit	20%
Eksperience në organizim eventesh të ngjashme.	40%
Staf dhe pajisjet teknike të nevojshme për organizimin e eventit.	40%

10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak.

Nuk është përdorur njoftim paraprak në lidhje me këtë lloj shërbimi të kërkuar.